

Projekti: GEAR- "GREEN CODE"

For Social and Environmental Welfare Berat/ Per Mireqenie Sociale dhe Mjedisore Berat

Projekti "Kodi I Gjëlber" i nisur në shtator 2019 i mbylli aktivitetet e tij në Gusht të 2020.

Ai u realizua me fonde të BE, e u mbështet nga Qendra EDEN.

Organizata "Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore" e cila e realizoi në kushte të pazakonta për shkak të pandemisë, synoi të ofronte modele të reja që promovojnë zhvillimin e qendrushëm ekonomik dhe "ekonominë e gjëlber" në biznese beratase, që veprojnë në fushën e turizmit familjar.

- Përgjatë kohës së realizimit të projektit OJF-ja synoi nxitjen e teknikave innovative pranë biznesit familjar në mënyrën e re të menaxhimit të mbetjeve të përditshme, duke ofruar një kulturë të re menaxhimi të tyre, rritje të efikasitetit me moton "Për Beratit si pasuri botërore e UNESCO-s."
- Koordinim institucional midis bizneseve dhe pushtetit lokal, institucioneve lokale (qendra INFO-POINT etj), sensibilizimi me seminare teorike e praktike, botimeve si "Biodiversiteti dhe tradita, vlerat kulturore të parkut Kombëtar Tomorri" e realizuar nga vullnetarë të organizatës refuruar edhe në punën shkencore të Zj Mahmutaj, mbi resurset e Parkut Kombëtar të Tomorrit, dhanë një vision të ri mbi risitë që një ka qyteti i Beratit e ndërlidhja me mjedisin e turizmin e Gjëlber.
- Target grupet e synuar në këtë projekt ishin të rinjtë, gratë brenda bizneseve familjare, menaxherët e hoteleve e bujtinave, individë që merren me Guida turistike, operatorë turistik, përfaqësues të institucioneve arsimor e institucione të tjerë të lidhur me "Ekonomi të gjëlber" si Ndërmarrja e gjëlberimit apo Administrata e Zonave të Mbrojtura, ishin partnerët tanë në këtë rrugëtim. Përfshirja e tyre me video në fushatën promovionale përgjatë një muaji, (si një nga etapat e projektit), mesazhe promovionale, aktivitete praktike si gropa kompostimi apo kompostim nga banorët, ishin risitë e ofruara nga ne për publikun beratas e institucione shtetërore. Rastet e sukseshme të bujtinave dhe hoteleve, përmendim bujtinat e Rrjetit të Gjëlber: Dëna Guest House, Hani i Xheblatit, Hotel Muzakaj, NOVA- Restorant, Castle Park, Dyqani Hand Made- Mangalem, Familja Goxhomani, Hotel Mangalem, Shtepia e Bardhe, Hotel Onufri, Hotel Portik, hotel Colombo, ne mbështetje edhe nga institucione lokale shtetërore: Prefektura, Keshill Qarku, Bashki, ishin pjesëmarrës vullnetarë të këtij zinxhiri të gjëlber.
- Këto biznese mirëpritën e bashkëpunuan me përfaqësues të organizatës, ngritën mjediset e kompostimit e krijuan humusin e luleve. Ato u prezantuan në "Fair FEST 2020" krahas punëve të shkëlqyera tradicionale të punës së dorës nga artizanë beratas. "FAIR FEST 2020" ishte i pari panair ne qytetin e Beratit qe prezantoi produkte modeste të një projekti i mbështetur mbi konceptet e ekonomisë së Gjëlber si Dhee te kompostuar nga mbetje te gjëlbra, kafesë- për të rritur lule dekorative për ambiente të jashtme, apo materiale të Riciklimit, ku nxënësit e shkollës Llambi Goxhomani, arritën të prezantonin mjete shkollore ndihmëse për vete por edhe për familjet që lëvrojnë turizmin familjar (mbajtëse kapësesh, kapëse perdeshe, penjsh, mbajtëse gjilpërash, mbajtëse stilolapsash të llojeve të mdrëshme etj).

Projekti: GEAR- "GREEN CODE"

For Social and Environmental Welfare Berat/ Per Mireqenie Sociale dhe Mjedisore Berat

- Projekti GEAR mbështeti Rrjetin e parë të gjelber "GREEN CODE", i cili solli risi në koncepte inovative si "KOMPOSTIMI, RICIKLIMI, EFICENSA" në ambiente bujtinash, hotelesh, restaurantesh, si dhe ambiente shteror. Tradita e risitë ishin bashkë për herë të parë në këtë Panair. Këto veprime të thjeshta të mbështetura në konceptet e ekonomisë së gjelbër, krijuan "Arin e ZI" të tokës që aq shumë i duhet bimëve, ulën sasi të mbetjeve të gjelbra, apo atyre ushqimore, por shërbyen edhe për argëtimin e vizitorëve në disa biznese ku startuam për implementim.
- Ne arritëm të ishim pranë qytetarëve, edhe si strat up, e sukcesi i faturohet vetëm bashkëpunimit të ngushtë me ta. Ndaj, ne gjejmë mundësinë t'i falenderojmë ata, duke i promovuar shumë pak nga puna e madhe, djersa që ata derdhin për të ngritur bizneset e tyre ([Ehttps://www.facebook.com/FSEE.BERAT](https://www.facebook.com/FSEE.BERAT)) (www.natyraberat.org)

Faleminderit!

Erjola Azizolli, gazetare

Organizata: "Per Mirëqenie sociale dhe Mjedisore" Berat